



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 04/2018

Datë: 15. 02. 2018. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 03/2018*

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- *Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Kamenicë ,Podujevë, Deçan, Malishevë, Istog dhe Gjilan;*
- *Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me ndryshimin e emrit të partisë politike nga “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK” në “Evropska Stranka Demokratske Akcije Kosova-ESDAK”;*
- *Shqyrtimi i rekomandimit për ndryshim të emrit të partisë politike nga “Nisma për Kosovën-NISMA” në “Nisma Socialdemokrate-NISMA”*

- *Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për shkatërrimin/asgjësimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve lokale 2017*

- **Këshilli i personelit**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i përshkrime të vendeve të punës të stafit të SKQZ-së*
- *Shqyrtimi i kërkesë së z. Kryeshfit Ekzekutiv të SKQZ-së;*

4. Të ndryshme:

2. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 03/2018

Valdete Daka: E kemi rendin e ditës, a ka kush ndonjë pyetje ?

Betim Gjoshi: Detyrimisht, kjo pika e fundit duhet me u përmirësua sipas rekomandimit të personelit...!

Adnan Rrustemi: Duhet me u heqë...

Bajram Ljatifi: Ne në mbledhje kemi marrë qëndrim ta informojmë KQZ-në se çka kemi shqyrtuar në këshill. Ne kemi nuk kemi marrë vendim, vetëm se “vendimin e parë” kemi thënë që ta shtyjmë për një javë ditë, kurse sipas vendimit të dytë, do të kërkojmë që mendim nga shërbimi për emërimin e zyrtarëve të larë, në lidhje me kërkesën e Bogolub Staletoviqit. Këtë, unë kam menduar që kur të vijë radha, vetëm si informacion...

Valdete Daka: Kush është për këtë rend dite me përmirësime. Tani, i kemi në radhë procesverbalet nr. 2 dhe 3.

Betim Gjoshi: Ju përshëndes, meqë kryeshefi nuk është por drejtoresha, po kërkoj që të rritet volumi i punës sepse, është bërë një praktikë që punët po mbesin që të kryhen në muajt e fundit nëntor e dhjetor. Që të them konkretisht, te Këshilli Ligjor ne e kemi shkelë edhe rregulloren e punës sepse, ka 16 ditë që kërkesa për zëvendësim të asamblistëve ka ardhur dhe ne nuk e kemi kryer detyrën si duhet. Është mirë me e rritë ritmin e punës, me i pa shpenzimet etj. Po krijohet një gjendje konfuze, sepse kemi prioritete si për shembull realizimin e konkurseve. Ju lutem ta rrisim aktivitetetin, këshillat të takohen më shpesh po edhe KQZ.

Valdete Daka: Nuk kam asgjë personale, por mezi e kam shtyrë me u mbajte kjo mbledhje. Nuk e di ku është problemi, se di pse po sfidohet mbajtja e mbledhjeve. Sidomos, kemi prioritet realizimin e

konkurseve, pozitive të lira që i kemi qe 5 vjet dhe që nuk po plotësohen...! Si me zor, i ka shtyrë me i mbajtë përshkrimet, nëse edhe janë bërë...Nuk po mundem me e akceptue se, ku janë problemet...

Adnan Rrustemi: Ne e kemi miratuar një plan të punës, performanca e të cilit ishte dashur të vërehet që në muajt e parë. Dhe, ka aktivitete që të paktën ishte dashur të fillohen, së paku në “shqyrtim dhe miratim”! Ne jemi në përfundim të shkurtit, dhe unë nuk di që ka ardhur ndonjë projekt në këshilla. E di që ka projekte, dhe se është dashur të vijnë...

Betim Gjoshi: Drejtoresha ma dha një informacion te shkatërrimin e materialit në këshill, tha se kemi mbërrirë te 60-shi. Përgatitjet si ndal askush, nuk duhet me qenë neglizhent. Sistemi zgjedhor nuk ka ndryshuar, ne e miratojmë s’ka asnjë problem ama, duhet me qenë ma të përgatitur.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nr. 3/2018

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

1. Shqyrtimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Kamenicë, Podujevë, Deçan, Malishevë, Istog dhe Gjilan;

Bajram Ljatifi: Në këtë këshill, në mungesë të kryesuesit të tij e kam kryesuar mbledhjen e fundit. Në mbledhje, kemi shqyrtuar kërkesat për zëvendësimin e asamblistëve:

Në komunën e Kamenicës, Enver Mavriqi nga subjekti politik AAK, zëvendësohet nga Isak Hoda.

Në komunën e Podujeves, Faik Muçiqi, nga subjekti politik LDK, zëvendësohet nga Afrim Shabani.

Në komunën e Malisheves, Islam Vrenezi, zëvendësohet nga Genc Shurdhaj.

Në komunën e Deçan, Qazim Maloku, zëvendësohet nga Milazim Mushkolaj.

Në komunën e Pejës, Astrit Demaj, zëvendësohet nga Avni Shala.

Në komunën e Pejës, Fatmir Asllani, zëvendësohet nga Nezir Berisha.

Në komunën e Istogut, Lulzim Blakaj, zëvendësohet nga Sefedin Byqyi.

Në komunën e Gjilanit, Fejzullah Berisha, zëvendësohet nga Shemsedin Ilazi.

Në komunën e Obiliqit, Slavisha Jakovleviq, zëvendësohet nga Slavisha Spasiq.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këto zëvendësime

2. **Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me ndryshimin e emrit te partisë politike nga “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK” ne “Evropska Stranka Demokratske Akcije Kosova-ESDAK”**

2. **Bajram Ljatifi:** Zyres për Regjistrimin e Partive Politike, i ka ardhur kërkesa nga subjekti politik “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK” për ndryshimin e emrit, por që nuk e kanë bërë ndryshimin e duhur. Zyra, në bazë të ligjit, pastaj ka konfirmuar se ky subjekt i ka bërë përmirësimet ashtu siç edhe është kërkuar, dhe kërkesa ka ardhur në këshill. Ne, e kemi shqyrtuar kërkesën e zyrës mbi ndryshimet e bëra dhe se, çdo gjë ka qenë në rregull dhe ne, rekomandojmë që kjo të miratohet. Dhe, ky subjekt nga “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK”, shndërrohet në “Evropska Stranka Demokratske Akcije Kosova-ESDAK”

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan rekomandimin e zyrës.

3 **Shqyrtimi i rekomandimit për ndryshim te emrit te partisë politike nga “Nisma për Kosovën-NISMA” në “Nisma Socialdemokrate-NISMA”**

Bajram Ljatifi: Ky subjekt politik, ka bërë ndryshimin e emrit nga “Nisma për Kosovën” siç ka qenë, në “Nisma Socialdemokrate”. Këshilli e ka shqyrtuar kërkesën, dhe ne rekomandojmë që të aprovohet rekomandimi ynë që do të thotë, “Nisma për Kosovën”, shndërrohet në “Nisma Socialdemokrate”.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim të zyrës.

4.**Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për shkatërrimin/asgjësimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve lokale 2017**

Bajram Ljatifi: Edhe këtë pikë, e kemi shqyrtuar dhe ne, në disa pjesë kemi dhënë udhëzime si të realizohet ky proces...Por, ne do të vendosim për këtë...!

Valdete Daka: Ne, e kemi edhe një shkresë nga PZAP për disa kuti që ata i kanë drejtuar ë prokuroritë përkatëse. Është edhe shkresa ime që ia kam dërguar prokurorisë, por nuk po shoh përgjigje...Është edhe një kërkesë imja drejtuar Burimit që të na informojë lidhur me ata që kanë votuar me kusht më shumë se njëherë, dhe as prej atij nuk kam marrë informacion...Dhe, kutitë që kanë pasur shumë gabime, përtej normalitetit: në ato kuti ku ka pasur 20, 50 e më shumë fletëvotime që kanë qenë jo në rregull, unë konsideroj që ende nuk mund t’i shkatërrojme materialet...

Betim Gjoshi: Ne, nuk po marrim vendim...ne, vetëm mund të kërkojmë që kjo të bëhet pas marrjes së përgjigjeve të caktuara..

Adnan Rrustemi: Të veprohet me ligj, të zhvillohen procedurat...! Por, nuk duhet harruar se janë dy aktivitete në plan të punës që lidhen me procesin zgjedhor: 1. Analizë e fletëvotimeve të pavlefshme. 2. Analiza e votimit me asistencë, rrjedhimisht analizë librave të votimit...

Jam dakord që ta bëjmë miratimin në parim, pra edhe të fillojnë procedurat por që, mos të zbatohet asgjë pa u marrë informacionet, përgjigjet...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e këshillit me ndryshimet e duhura.

- **Këshilli i personelit**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i përkrahjeve të vendeve të punës të stafit të SKQZ-së

Bajram Ljatifi: Në mbledhjen e këshillit, i kemi shqyrtuar dy pika: 1. përkrahje të vendeve të punës të stafit të SKQZ-së. Pas shqyrtimit të materialit dhe diskutimeve të stafit, këshilli ka theksuar se pozicionet që janë tani, janë ende në nivelin para mbajtjes së vork shopi-it, dhe se, nuk duhet të veprohet ndryshe. Kemi vendosur që, çështjet të kthehen edhe njëherë në shqyrtim pozitat sepse, ato nuk janë në korrelacion me vendimin që e kemi marrë në punëtorinë në Shqipëri. Pra, edhe njëherë të shqyrtohen deri në fund të javës...

Valdete Daka: Këtu edhe janë problemet sepse, as mbledhje nuk po mbahen...Është neglizhencë e madhe mos shpallja e pozitave...

Betim Gjoshi: Ne, kemi mbajtur katër palë zgjedhje dhe, nuk janë realizuar konkurset, e kemi marrë staf jo permanent...

Bajram Ljatifi: Në bazë të ish kërkesës së zëvendësit të Kyreshes, z. Bogolub Staletoviq, këshilli përfundon se, duhet t'i drejtohem Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës lidhur me këtë kërkesë.

Betim Gjoshi: Më shumë se sa vitet që ai e ka pezulluar punën, janë me rëndësi çështje tjera: A ka qenë zyrtar i përhershëm apo me kontratë, sepse pozitat e larta janë me mandat. E dyta, duhet pyetur KPM-në se, a kanë të drejtë jashtë mandatit që kanë pas me pezulluar punën – pozitën e lartë drejtuese sepse, ai ka qenë zëvendës kryeshef. Nuk ka qenë zyrtar i thjeshtë. Kur e lexova ligjin, te zyrtarët e përhershëm është e drejta e pezullimit, por te pozitat e larta as që përmendet...Logjikisht, duhet të dimë se çka ta pyesim KPM-s...

Adnan Rrustemi: Mendoj që, është dashur të silllet dosja në KQZ para se me shkuar në KPM. Nuk është asnjë këshill, autoritet që mundet jashtë KQZ, me kërkuar nga një palë e tretë as mendim, as shqyrtim, as vendim...Nuk po dyshoj në përpjekje për t'i dhënë zgjidhje problemit, por ne sikur jemi privilegj që t'i japim zgjedhje kësaj çështje...Mendoj që, para se çështja të kthehet në këshill, KQZ duhet ta shqyrtoj këtë problem, mirëpo nëse veç keni vendosur vazhdoni...

Betim Gjoshi: Edhe unë mendoj që dokumentacioni i këtij rasti, është dashur të sillet tek ne. Në anën tjetër, kur kemi marrë qëndrim ne e kemi marrë për tri vjet. Debati, ka qenë që ti pezullohet puna për tri vjet...Kurse atij, i ka kaluar mandati qe katër vjet...

Valdete Daka: Më fal, atij nuk i ka kaluar mandati në Ombudsperson, ai është suspenduar...!

Betim Gjoshi: Epo, edhe kjo pyetje duhet bërë KPM –së, ngase ai është suspenduar, nuk i ka kaluar mandati...

Eshref Vishi: Këto veprime janë të rregulluara me procedura, dhe është mirë t'i shohim...Nuk mund të gjykohet një rast shpejt e shpejt...Kështu që, le të përgatitet dokumentacioni...

Valdete Daka: Ka mbetur edhe çështja e Auditimit...Raporti...!

4. Të ndryshme: